



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 18 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/21) dhe nenin 64, paragrafi (3) nga Ligji për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 167/ 20)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14, 223/15, 218/16 dhe 221/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 181/19 dhe 116/20), në pikën 66, pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), që thotë:

"Gjatë përcaktimit të afatit total të maturimit nga paragrafi (5) të kësaj pike nuk merret parasysh vazhdimi i afatit të maturimit të kredive konsumatore të realizuar në periudhën nga 25 marsi deri 30 shtator 2020, në pajtim me pikën 58-b të Vendimit për metodologjinë e menaxhimit me rrezikun kreditor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 149/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 76/20 dhe 116/20)."

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**V. nr. 02 - 15/ IX-1/2020
19 qershor 2020
Shkup**

**Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска**